



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

**RAPORT MONITORIMI MBI ZBATIMIN E PLANIT TË
INTEGRITETIT PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

KORRIK - DHJETOR 2025

Hyrje	3
Metodologjia e Monitorimit	4
Monitorimi dhe Raportimi	7
Analiza e Zbatimi të Planit të Veprimit gjatë periudhës Janar-Qershor 2025.....	9
Konkluzione dhe Rekomandime	17

HYRJE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka hartuar Planin e Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili shërben në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve, që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjike dhe specifike të institucionit.

Plani i Integritetit për Zyrën e ILD do të shërbejë si një dokument i brendshëm me karakter udhëzues, në të cilin janë përcaktuar objektivat për forcimin e etikës dhe integritetit, që do të udhëheqin punonjësit e Zyrës së ILD gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe aktet e brendshme të ILD. Ky Plan mbështetet dhe i vjen në ndihmë respektimit të parimeve mbi të cilat organizohet dhe funksionon Zyra e ILD si: hierarkia, llogaridhënia, ligjshmëria, efektiviteti, paanësia, mos-diskriminimi, si dhe bashkëpunimi. Gjithashtu, përmirësimi i performancës së institucionit, rritja e transparencës e llogaridhënies, integriteti dhe profesionalizmi në ushtrimin e detyrave, kontribuojnë në përmirësimin e imazhit të institucionit dhe rrjedhimisht, në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit dhe sistemit të drejtësisë.

Për sa më sipër, qëllimi i Planit të Integritetit të Zyrës së ILD është konsolidimi i një sistemi të brendshëm të menaxhimit të integritetit për të eliminuar rrethanat dhe minimizuar rreziqet e sjelljeve jo etike, jo profesionale dhe veprimeve korruptive të të gjithë punonjësve të Zyrës së ILD gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR RAPORTIN E PLANIT TË INTEGRITETIT

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor nxjerrjen në pah të arritjeve, sfidave dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky raport përmban një analizë cilësore dhe sasiore të kontributit të strukturave përgjegjëse për zbatimin e masave duke grumbulluar nga njësitë përgjegjëse informacionin e dëshiruar nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo rekomandim të parashikuar për zbatim në periudhën e raportimit.

Fazat e ndjekura për hartimin e raportit të monitorimit të Planit të Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Dërgimi i kërkesës për kontribut tek të gjitha njësitë përgjegjëse;
- Koordinimi dhe unifikimi i të dhënave të ardhura nga informacionet;
- Shqyrtimi i ecurisë së treguesve dhe alternativa për nën aktivitete;
- Hartimi i raportit të monitorimit.

Metodologjia e analizimit të të dhënave për Planin e Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke vënë në pah edhe anën vizuale. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Objektivat Strategjike.
- Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin e masave është prezantuar sipas nivelit të zbatimit, në përqindje dhe me anë të grafikeve.
- **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve** (në përqindje) është ai i raportuar nga secila njësi përgjegjëse, nga ku evidentohet numri i aktiviteteve të realizuara për periudhën raportuese përkundrejt përmbushjes së plotë të rekomandimit në afatin e përcaktuar.

Gjithashtu, shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar në tre tregues dhe e përlllogaritur në përqindje, konkretisht:

- **E zbatuar**- masë e cila është përmbushur në vlerën 100%;
- **Pjesërisht e zbatuar/Në proces** - masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në proces zbatimi në vlerën 50%-90%.
- **E pazbatuar** - masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese (vlera e raportuar 0%)

Objektivi nr. 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) me qëllim forcimin e integritetit-institucional

Ky objektivi specifik konsiston në zbatimin e një kuadri strategjik të harmonizuar me sisteme të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetit dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional dhe garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësive dhe kompetencave. Mospërmbushja e këtij objektivi ka bërë që të ndërmerren masa dhe rekomandime dhe konkretisht ky objektivi përfshin 9 rekomandime për zbatim nga ana e strukturave përkatëse, nga të cilat 3 rezultojnë me risk të lartë të mundshëm dhe 6 me një risk mesatar të mundshëm në kuadër të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Objektivi nr. 2: Përmirësimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimi me qëllim rritjen e besimit të publikut tek veprimtaria e ILD

Forcimi i rolit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kryerjen e inspektimeve tematike është një proces i rëndësishëm në drejtim të identifikimit të problematikave që haset sot sistemi i drejtësisë me qëllim për ta ndihmuar atë të performojë sa më mirë, në shërbim të interesave të qytetarëve, duke iu përgjigjur në kohë, me drejtësi dhe paanshmëri nevojave të shoqërisë për drejtësi. Kjo realizohet përmes rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional me qëllim përcjelljen e tematikave apo çështjeve që vlerësohen të ndjeshme dhe se kanë nevojë për inspektim.

Objektivi nr. 3: Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi, i cili paraqet risk mesatar për veprimtarinë e institucionit dhe mbarëvajtjen e tij, lidhet me aktivitete, të cilat brenda periudhës së zbatimit të planit të integritetit do të mundësojnë trajnime lidhur me etikën dhe integritetin, konfliktin e interesave, identifikimin dhe vlerësimin e riskut, sigurinë e informacionit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, kufizimin e të drejtës për informim etj.

Objektivi nr. 4: Përmirësimi i transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut

Masat/aktivitetet që përfshihen në këtë objektivi paraqiten me risk të nivelit mesatar, por ndikojnë tek imazhi që institucioni gëzon tek qytetarët, por edhe me rritjen e besimit tek publiku. Në këtë kuadër e pritshme mbetet Zbatimi i Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik 2022- 2023, si dhe përditësimi i Programit të Transparencës dhe plotësimi me informacionin e nevojshëm.

Objektivi nr. 5: Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar

Masat apo rekomandimet në kuadër të këtij objektivi, lidhen me ndërmarrjen e masave për minimizimin e riskut, pasi një pjesë e madhe e tyre janë identifikuar si fusha që paraqesin risk

të lartë pasi lidhen ngushtësisht me funksionimin e mirë të institucionit të cilat përfshijnë buxhetin, mungesën e Auditimit të brendshëm, hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut për Zyrën e ILD, si dhe rishikimin apo plotësimin e Regjistrit dhe Matricës së Riskut për Zyrën e ILD.

Ato rekomandime që janë paraqitur me risk më të ulët lidhen me zhvillimin e veprimtarisë së ILD, por për mirëfunksionimin e këtij të fundit, lind e nevojshme hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit të brendshëm për Monitorimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për Zyrën e ILD-së, si dhe Hartimi dhe miratimi i një udhëzimi mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik për Zyrën e ILD-së.

Objektivi nr. 6: Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit të ruajtjes së dokumenteve strategjike

Zhvillimi i infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit ka qenë gjithashtu në fokus të punës së ILD. Është krijuar sistemi elektronik i brendshëm për menaxhimin e ankesave (SMAD), janë miratuar rregullat për sigurinë në mbrojtje të informacionit, që administrohet nga të gjithë strukturat e Zyrës së ILD me qëllim ruajtjen e integritetit, disponueshmërisë dhe konfidencialitetit të aktiveve të teknologjisë dhe zbatimin e masave teknike dhe organizative për të ruajtur sigurinë e aktiveve nga kërcënime reale apo potenciale, që prekin sistemet elektronike dhe ato të arkivimit të informacionit.

Megjithatë ky objektivi paraqitet me risk të lartë për shkak të rëndësisë dhe ndjeshmërisë që ka lidhur me funksionimin e institucionit, andaj edhe aktivitetet përfshijnë masa që lidhen me minimizimin e riskut.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Planit të Integritetit 2023-2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka miratuar urdhrin nr. 122/1, datë 27.12.2023, "Për mënyrën e monitorimit, raportimit dhe zbatimit të planit të Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025".

Plani i Integritetit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmban objektivat kryesorë të cilat lidhen me vlerësimin e rrezikut ndaj integritetit për të gjitha proceset e punës në institucion, të cilët mund të kompromentojnë aftësinë e Zyrës së ILD për të kryer funksionin publik në mënyrë të paanshme, të përgjegjshme dhe profesionale, si dhe formulimin e masave të përshtatshme për adresimin e tyre.

Plani i Integritetit 2023-2025, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konsiston në:

- > 6 (gjashtë) Objektiva; dhe
- > 29 (njëzet e nëntë) Rekomandime;

Plani i Integritetit gjendet i përcaktuar në 6 (gjashtë) objektiva të shpërndara përkatësisht në 29 (njëzet e nëntë) rekomandime, me një përshkrim të rezultateve të pritshme, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektivi.

Bazuar në urdhrin nr. 122/1, datë 27.12.2023, "Për mënyrën e monitorimit, raportimit dhe zbatimit të planit të Integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025", është përcaktuar mënyra e procesit të monitorimit, detyrimi për raportim sipas çështjeve që mbulojnë njësitë që kanë në objekt të veprimtarisë masa apo aktivitete konkrete, afatet dhe struktura përgjegjëse për monitorimin e Planit të Integritetit 2023-2025.


Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin për zbatimin e masave të Planit të Integritetit 2023-2025 të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është Sektori i Analizës dhe Studimeve, i cili nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, grumbullon përpunon informacionin në funksion të monitorimit të zbatimit të Planit të integritetit nga njësitë përgjegjëse.

Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e autoritetit kompetent për të siguruar ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, zhvillon takime për të diskutuar mbi ecurinë e masave të parashikuara në plan me titullarët e njësive përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara. Takimet në kuadër të Planit të Integritetit, zhvillohen jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo rast që çmohet e nevojshme, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm.

Në përmbushje të detyrave funksionale Sekretari i Përgjithshëm, do të asistohet nga specialisti i Sektorit të Studimeve dhe Analizës.

Në përfundim të çdo periudhe monitorimi, raporti i monitorimit i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përmbushjen e objektivave për periudhat përkatëse të paracaktuara, mbi zbatimin e rekomandimeve të "Planit të Integritetit për periudhën 2023-2025", bashkë me përllogaritjen në përqindje (%), si një kriter matës mbi përmbushjen e aktiviteteve sipas çdo objekti specifik.

Në kuadër të kontributeve të ardhura për përmbushjen e rekomandimeve të përcaktuara, për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025, rezulton se objektivat e synuara në kuadër të Planit të Integritetit për periudhën e raportimit, të jenë realizuar në vlerat e mëposhtme:



ANALIZA E ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT GJATË PERIUDHËS KORRIK - DHJETOR 2025

Gjatë periudhës së raportimit Korrik- Dhjetor 2025 është përcjellë informacioni i përgjithshëm mbi realizimin e çdo rekomandimi, lidhur me Objektivat e përcaktuara në Planin e Integritetit.

Sa i përket rekomandimeve përkatëse të secilit prej 6 objektivave të përfshira në Planin e Integritetit, vlen të theksohet se disa prej tyre kanë përmbushur qëllimin e tyre dhe janë realizuar brenda vitit 2024 dhe nuk ka të dhëna në monitorimin e Planit të zbatimit të Integritetit për periudhën korrik - dhjetor 2025.

Objektivi 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të ILD, me qëllim forcimin e integritetit institucional

Ky objektivi për periudhën raportuese përmban 2 rekomandime të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për periudhën raportuese, të cilat i referohen kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e Drejtorisë së Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Gjatë periudhës raportuese janë kryer aktivitetet sipas tabelës së mëposhtme, konkretisht:

Objektivi 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për realizimin e funksioneve të ILD, me qëllim forcimin e integritetit institucional	
Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik - Dhjetor 2025	Niveli i Realizimit
Numri i inspektorëve magjistratë të komanduar pranë ILD vijon të mbetet i ulët krahasuar me vendet vakante. Trajtimi jo i barabartë financiar midis inspektorëve magjistratë dhe atyre jo magjistratë;	75%
Metodologjia e analizës dhe Raportimit të informacionit statistikor	50%

Nga të dhënat për periudhën e raportimit rezultojn se;

- 1 rekomandim është realizuar pjesërisht, në masën 75%;
- 1 rekomandim është realizuar pjesërisht, në masën 50%;

Sa i përket rekomandimit lidhur me numrin e inspektorëve magjistratë të komanduar pranë ILD, është përmbushur 75 %, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka hartuar kërkesat drejtuar Këshillave për komandimin e magjistratëve pranë ILD-së, konkretisht:

- Shkresa nr. 2441 prot., datë 02.09.2025 drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor për nisjen e procedurave për komandimin e 5 (pesë) magjistratëve gjyqtar për pozicionin inspektor pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Shkresa nr. 2442 prot., datë 02.09.2025 për nisjen e procedurave për komandimin e 1 (një) magjistrati gjyqtar për pozicionin këshilltar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shpallur listën e kandidatëve që kanë aplikuar për komandim në pozicionin e këshilltarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga procedurat e mëparshme të komandimit, në këtë periudhë është komanduar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë 1 (një) magjistrat (prokuror) për pozicionin inspektor magjistrat pranë Zyrës së ILD-së.

Në lidhje me ndryshimet ligjore, të ardhura për mendim dhe komente nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisioni Parlamentar për

Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale, për dy nismave parlamentare, konkretisht projektligji. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën nr. 3836/1 prot., datë 09.01.2026 ka përcjellë komente sugjerime, propozime dhe dakordësi mbi dispozitat e propozuara.

Duke qenë se ndryshimet ligjore, për periudhën e raportimit janë në shqyrtim, parashikimi në buxhet i trajtimit të barabartë financiar nuk është realizuar.

Sa i përket rekomandimit i cili lidhet me raportimin e informacionit statistikor, nga struktura përgjegjëse raportohet se ankesat e depozituara dhe të trajtuara, grumbullohen, analizohen dhe raportohen në mënyrë periodike ditën e fundit të çdo jave. Në funksion të përmbushjes së rekomandimit, janë rishikuar dhe përditësuar modelet për gjenerimin e raporteve periodike 3 mujore, 6 mujore, 9 mujore. Këto raporte janë hartuar në kuadër të procesit të hartimit të Kontributit për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë e vitit 2025, Raportet e monitorimit për Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe çdo raport tjetër të kërkuar nga institucione të tjera apo dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Objektivi 2. Përmirësimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit me qëllim rritjen e besimit të publikut te veprimtaria e ILD

Ky objektivi përmban 4 rekomandime të planifikuara për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira, për periudhën e raportimit të cilat i referohen procesit të verifikimit, hetimeve dhe inspektimeve, përmirësimit të proceseve të tyre.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë njësia e inspektorëve dhe ndihmësinspektorëve, dhe konkretisht:

Objektivi 2. Përmirësimi i procesit të verifikimit, hetimit disiplinor dhe inspektimit me qëllim rritjen e besimit të publikut te veprimtaria e ILD	
Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik – Dhjetor 2025:	Niveli i Realizimit
Vlerësimi i etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve;	100%
Trajtimi i ankesave në përputhje me afatet kohore të përcaktuara, për arsye të backlog të trashëguar dhe vakancave.	50%
Mungesa e kërkesave të motivuara me shkrim nga KLGJ, KLP, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme për kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike;	100%
Kalendari i trajnimeve për inspektorët jo magjistratë; Trajnimet në fushën e hetimit disiplinor dhe inspektimeve nuk ofrohen në mënyrë të vazhdueshme sipas një kalendari të përcaktuar;	100%

Nga të dhënat për periudhën e raportimit rezulton se,

- 3 rekomandime janë realizuar plotësisht në masën 100%
- 1 rekomandim është realizuar pjesërisht në masën 50%;

Sa i përket rekomandimit të parë që lidhet me Vlerësimin Etik dhe Profesional për periudhën e raportimit ka përfunduar vlerësimi për katër inspektorë magjistratë E.P., L.Z., D.S., dhe J. Z. Në muajin nëntor është miratuar programi i vlerësimit etiko-profesional për vitin 2026, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në kuadër të programit të vlerësimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar urdhrin për fillimin e procesit të vlerësimit etiko-profesional të 2 (dy) inspektorëve jomagjistratë E.B dhe P.T.

Lidhur me shqyrtimin e ankesave brenda afateve, duke qenë se backlog ka përfunduar në vitin 2023, për këtë periudhë raportimi prioritet ka qenë shqyrtimi i një numri të lartë ankesash. Në këtë drejtim është miratuar urdhri nr. 148, datë 31.12.2025 lidhur me të dhënat që duhet të përmbajnë raportet analitike mbi tematikën e ankesave dhe periodicitetin e hartimit të tyre. Ky urdhër synon grumbullimin e të dhënave sipas pretendimeve, duke krijuar lehtësi në shqyrtimin e ankesave. Vendosija e përparësive mbi pretendimet ka shpejtuar shqyrtimin e ankesave, duke e rritur numrin e ankesave të trajtuara për këtë periudhë. Të dhënat statistikore tregojnë se për periudhën 1 janar – 30 qershor 2025 janë trajtuar 812 ankesa, ndërsa për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2025 janë trajtuar 823 ankesa. Numri i ankesave të trajtuara përgjatë vitit 2025 arrin në 1 635 ankesa, çka pasqyron rritjen e kapacitetit për trajtimin e ankesave dhe ndikim pozitiv në masat e ndërmarra për përshpejtimin e procesit të shqyrtimit.

Në lidhje me kryerjen e inspektimeve institucionale dhe tematike, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka hartuar kërkesat drejtuar KLGJ, KLP, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë lidhur me propozime të tematikave të inspektimit për planin e inspektimeve të vitit 2026. Kanë kthyer përgjigje Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Sa i përket kalendarit të trajnimeve për inspektorët jo magjistratë, raportohet se për periudhën Korrik - Dhjetor 2025 janë zhvilluar trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (Inspektor & Ndihmës Inspektor) dhe trajnime me ekspertë të huaj, konkretisht:

- Në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis ILD & Shkollës së Magjistraturës, janë përcjellë pranë SHM formularët e aplikimit për pjesëmarrje në sesionet e trajnimit vazhdues, në 32 tematika trajnimi për Inspektorë dhe Ndihmës Inspektorë.
- CEPEJ:
 - Rritja e aftësive inspektuese sipas udhëzuesve të CEPEJ’.
- EU4JUSTICE:
 - Thellimi i njohurive mbi inspektimet tematike dhe institucionale.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) në fushat e hetimeve disiplinore dhe inspektimeve.
- Mekanizmat disiplinorë si pjesë e integritetit dhe transparencës së sistemit gjyqësor.
- Organizimi i një tryeze të rrumbullakët për të diskutuar rolin e gjyqtarëve në një shoqëri demokratike dhe funksionin e inspektimeve gjyqësore”, ku qëllimi i aktivitetit ka qenë: “Të nxisë një dialog të hapur dhe konstruktiv mbi rolin e gjyqtarëve në një shoqëri demokratike, me një fokus të veçantë në ruajtjen e pavarësisë gjyqësore, sigurimin e llogaridhënies dhe ruajtjen e besimit publik në gjyqësor. Diskutimi do të shqyrtojë gjithashtu funksionin e inspektimeve gjyqësore si një mekanizëm kyç për të mbrojtur integritetin dhe efikasitetin e aktivitetit gjyqësor, duke respektuar parimet e drejtësisë dhe ndarjes së pushteteve”.

➤ ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E POLICISË:

- Criminials Psychology & Forensics Technology

➤ KUVENDI I SHQIPËRISË:

- Shkolla e Integritetit European

➤ RESIJ:

- Çështjet e brendshme të ndryshimeve në statutin e RESIJ

➤ AKSIK:

- Trajnim mbi listën e funksioneve organike që për shkak të detyrave zyrtare mund dhe duhet të njihen informacione të caktuara.

➤ INSTITUCIONET E DREJTËSISË NË MBRETËRINË E BASHKUAR:

- Ndarja e praktikave të mira mes institucioneve dhe roli që ka procesi i inspektimeve në efikasitetin e sistemit të drejtësisë për promovimin e transparencës e paanësisë, në shërbim të besimit të publikut.

Objektivi 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të rezistuar shkeljeve të integritetit

Ky objektivi përmban një rekomandim të planifikuar për t’u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimit të punonjësve, zhvillimin profesional të tyre me qëllim shmangien e konflikteve të interesit, rezistencën ndaj shkeljeve të integritetit me anë të trajnimeve të punonjësve.

Njësia raportuese për këtë veprimtari është Sektori i Burimeve Njerëzore.

Objektivi 3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimi profesional i tyre për të rezistuar shkeljeve të integritetit

Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik - Dhjetor 2025	Niveli i Realizimit
Nevoja për thellim të njohurive dhe rritje të kapaciteteve të punonjësve të Zyrës së ILD-së në fusha të ndryshme	100%

Sa i përket rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të punonjësve të Zyrës së ILD-së në fusha të ndryshme janë identifikuar dhe vlerësuar nevojat për trajnim dhe në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis ILD & Shkollës së Magjistraturës, janë përcjellë pranë SHM formularët e aplikimit për pjesëmarrje në sesionet e trajnimit vazhdues, 32 tematika trajnimi për Inspektorë dhe Ndihmës Inspektorët.

Për periudhën Korrik - Dhjetor 2025 kanë ndjekur trajnime të gjithë punonjësit/nëpunësit e të gjitha niveleve, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës (Inspektor & Ndihmës Inspektor), ASPA (për nëpunësit civil) dhe trajnime me ekspertë të huaj. Janë ndjekur 5 trajnime të ofruara nga ASPA (për nëpunësit civil), 1 trajnim i zhvilluar nga CEPEJ, 4 trajnime ofruar nga EU4JUSTICE, 1 trajnim nga RESIJ si dhe 1 trajnim organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Policisë.

Objektivi 4. Përmirësimi i transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut

Ky objektivi i referohet informimit të qytetarëve në funksion të rritjes së besimit të publikut te veprimtaria e institucionit dhe Programit të Transparencës.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun.

<i>Objektivi 4. Përmirësimi i transparencës institucionale dhe konsolidimi i besimit të publikut</i>	
Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik - Dhjetor 2025	Niveli i Realizimit
Zbatimi i Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik	42.80%

Për periudhën raportuese, nga sektori përgjegjës raportohet se Programi për Informimin dhe Komunikimin Publik ka pasur në qendër të punës së tij raportin me qytetarin, së pari si ankues për shkelje disiplinore të pretenduara ndaj gjyqtarëve e prokurorëve dhe së dyti si qytetar i informuar, përmes aktiviteteve për edukim ligjor me grupe të ndryshme shoqërore.

Gjatë periudhës së raportimit është hartuar një tjetër program edukimi, që do të shtrihet për zbatim deri në vitin 2028 e për të cilin pritet miratimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Programi për informimin, edukimin ligjor dhe sensibilizimin e qytetarëve është një plan, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e ka gjeneruar bazuar në nevojat e konstatuara nga takimet fizike me qytetarët, komunikimi përmes linjës telefonike, si dhe të dhënat që janë mbledhur përmes ankesave, informacioneve dhe rrugëve të tjera të informimit publik, si dhe

projeksionin e institucionit bazuar në të gjithë veprimtarinë e vet. Ky program përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin ligjor, informimin e qytetarëve dhe sensibilizimin e tyre, bazuar në objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin ligjor, informimin dhe sensibilizimin është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvaret edhe nga kontributi i aktorëve të tjerë, që mund të bashkëveprojnë në këtë fushë me të cilët Zyra e ILD-së ka aktualisht marrëveshje bashkëpunimi, apo që mund të ketë në të ardhmen. Janë organizuar 15 aktivitete nga Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, nga të cilat 10 vetëm për edukimin, informimin dhe sensibilizimin e publikut.

Janë realizuar 15 aktivitete të cilat përfshijnë takime me grupe të të rinjve, me Organizata të Shoqërisë Civile me fushë veprimtarie transparencën dhe aksesin e publikut në drejtësi, si pjesë e strategjisë së komunikimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Janë planifikuar 6 aktivitete për muajit korrik-dhjetor 2025 me studentë, avokatë, media e të tjera dhe janë realizuar 5 prej tyre. Në audiencën e synuar dhe që është realizuar në masën më të mirë të mundshme kanë qenë takimet me organizata të Shoqërisë Civile, si dhe grupe të të rinjve studentë nga Kosovë, ata të Akademisë e Integritimit dhe Negociatave, si dhe nxënës të shkollës “Sami Frashëri”.

Në funksion të transparencës për veprimtarinë e institucionit por edhe aksesin e publikut janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës. Vëmendja maksimale ka qenë tek, Faqja zyrtare eë.ild.al e përditësuar në informacion, në shqip dhe anglisht. Pritja e qytetarëve çdo ditë pune, nga e hëna në të premte (nga ora 09.00-14.00) duke i asistuar sipas nevojës në plotësimin e formularit TIP të ankesës përmes punonjësve të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, si strukturë përbërëse e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Buletini mujor i ILD-së vijoi edhe gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025 të ishte informues periodik mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Gjatë vitit 2025 janë parashikuar shumë aktivitete për edukimin ligjor të publikut, por vetëm disa prej tyre janë zhvilluar edhe për shkak të kufizimit nga Zgjedhjet Parlamentare, të cilat kufizuan kohën dhe nuk na dhanë mundësinë e zbatimit të kalendarit të aktiviteteve.

Nuk ka pasur bashkëpunime direkte me median, por të gjitha takimet, aktivitetet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo trajnimet e Njësisë së Inspektorëve dhe Ndhimës inspektorëve janë publikuar në mediat online ndër më të rëndësishmet në vend. Më shumë se 100 botime mediatike kanë qenë në harkun e 6 mujorit të dytë të vitit 2025. Gjithashtu ka pasur edhe transmetime live në mediat televizive për aktivitetet e rëndësishme, që janë organizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në muajin dhjetor të vitit 2025 është hartuar një tjetër program për informimin dhe edukimin, që do të shtrihet për një afat 3-vjeçar, në përmbajtje të të cilit janë parashikuar në detaje aktivitetet në 12 qarqe të vendit me grupe të caktuara, duke filluar nga studentë, nxënës, media, organizata të shoqërisë civile, avokatë, psikologë e të tjerë. Çdo lajm, vendim me shpallje, përgjigje për kërkesat për informacion, botime të ndryshme janë publikuar në faqe. Programi

për tre vitet në vijim, i cili do të shtrihet për zbatim deri në vitin 2028, nuk është miratuar ende nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Objektivi 5. Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar

Ky objektivi përmban një masë të planifikuar, përmes së cilës synohet përmirësimi i mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar.

Njësitë përgjegjëse për raportimin e këtij objektivi janë: Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës, Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Ekipi për Menaxhimin e Riskut pranë ILD.

Objektivi 5. Përmirësimi i mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar	
Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik-Dhjetor 2025	Niveli i Realizimit
Tavanet buxhetore të përcaktuara nga MFE janë të pamjaftueshme dhe nuk mbulojnë nevojat imediate të ILD-së	100%

Nga të dhënat për periudhën e raportimit rezulton se, rekomandimi është realizuar plotësisht në masën 100%;

Nga të dhënat e përcjella nga struktura përgjegjëse raportuese, rezulton se për këtë periudhë janë ndërmarrë takime të vazhdueshme me Ministrinë e Financave, me qëllim përfshirjen në PBA të kërkesave buxhetore për vitet 2026 - 2028.

Me shkresën nr. 2151/1 prot., datë 29.08.2025 janë paraqitur formatet e PBA faza II, si dhe është kërkuar rishikimi i tavanëve të miratuara me VKM nr.372 dt.02.07.2025 ku janë paraqitur kërkesat buxhetore të ILD për vitin 2026. Në seancën dëgjimore të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është miratuar kërkesa për rishikimin e buxhetit të ILD në projektligj, duke përfshirë edhe kërkesën shtesë në vlerën 123 milionë lekë për ndërtimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve. Me ligjin 87/2025 " Për buxhetin e vitit 2026", në ligjin e ILD u përfshinë edhe kërkesat shtesë.

Objektivi 6. Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit e ruajtjes së dokumenteve digjitale

Ky objektivi përmban një masë të planifikuar për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për periudhën raportuese, përmes së cilës synohet zhvillimi i infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit, përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit, ruajtjes së dokumenteve digjitale.

Njësitë përgjegjëse për raportimin e këtij objektivi janë: Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Buxhetit dhe Financës, Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit dhe Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme.

Objektivi 6. Përmirësimi i teknologjisë së informacionit dhe administrimit e ruajtjes së dokumenteve digjitale

Rekomandimet e parashikuara për realizim për periudhën Korrik - Dhjetor 2025	Niveli i Realizimit
Projekti aktual për dhomën e serverëve nuk përmbush plotësisht standardet e përcaktuara për ndërtimin dhe administrimin	83%

Për periudhën e raportimit, nga të dhënat e përcjella, rezulton se rekomandimi rezulton i realizuar në masën 83%.

Lidhur me masën mbi hartimin e projekt-preventivit për Dhomën e Serverit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2025 ka siguruar fondet buxhetore për financimin e investimit si dhe ka zhvilluar procedurën me objekt, "Furnizim Vendorsje pajisje të Dhomës së Serverit". Në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fushën e prokurimeve publike, është ushtruar e drejta e ankimit për dokumentet e tenderit nga dy operatorët ekonomik dhe në vijim Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 967/6 prot., dhe datë 20.05.2025, të korigjuar ka vendosur të pranojë pjesërisht ankesat si dhe anulimin e procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor. Procesi i shqyrtimit të ankimit vijon të jetë në fazën e shqyrtimit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Nga objektivat e vendosura dhe të matur në Planin e Integritetit të Zyrës së ILD-së, për periudhën Korrik - Dhjetor 2025, të cilat janë 6 objektiva specifike dhe 12 aktivitete/masa që janë për realizim gjatë periudhës së raportimi, nga të cilat 7 prej tyre janë realizuar plotësisht dhe 5 prej tyre janë zbatuar pjesërisht:

- Numri i inspektorëve magjistratë të komanduar pranë ILD vijon të mbetet i ulët krahasuar me vendet vakante. Trajtimi jo i barabartë financiar midis inspektorëve. Kjo masë është me nivel realizimi 75% për këtë periudhë, duke qenë se është komanduar një magjistrat në pozicionin "inspektor" dhe ka filluar procedura për shpalljen pozicionit "këshilltar". Gjithashtu, edhe aktiviteti lidhur me trajtimin e barabartë financiar të inspektorëve jomagjistrat, ka patur zhvillim, pasi Kuvendi ka vendosur shqyrtimin e propozimeve të ILD-së për trajtim të barabartë financiar.
- Trajtimi i ankesave nuk arrihet gjithmonë në përputhje me afatet kohore të përcaktuara, për arsye të backlog të trashëguar dhe vakancave. Numri i ankesave të shqyrtuara, pavarësisht vendimmarrjes rezulton të jetë në nivele progresive edhe për këtë periudhë, çka nënkupton se ka një rritje graduale, nga periudha në periudhë. Të dhënat statistikore tregojnë se, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 janë trajtuar 812 ankesa ndërsa në gjashtë mujorin e dytë 823 ankesa, duke çuar në rritjen e kapacitetit për trajtimin e ankesave dhe ndikim pozitiv në masat e ndërmarra për përshpejtimin e procesit të shqyrtimit.

- Njohuri të kufizuara të publikut lidhur me fushën e veprimtarisë së ILD dhe mbi paraqitjen e ankesave pranë ILD- kjo masë mbetet e realizuar pjesërisht, pasi pritet të miratohet programi për informim dhe edukim për periudhën 2026-2028.
- Projekti aktual për dhomën e serverëve nuk përmbush plotësisht standardet e përcaktuara për ndërtimin dhe administrimin e tyre. Duke qenë se ky aktivitet i nënshtrohet rregullave të prokurimit publik, ecuria e zbatimit të arritjes së këtij objektivi, mbetet e varur nga ecuria e procesit të prokurimit, andaj edhe realizimi i tij është i kushtëzuar nga përfundimi i procedurës së prokurimit.

Pjesa tjetër e aktiviteteve janë realizuar në periudha të mëparshme, e për pasojë nuk kanë qenë objekt i monitorimit për këtë periudhë pasi janë realizuar brenda afateve të maturimit në periudha më të hershme.

Konkretisht për periudhën e raportimit gjejmë zbatueshmërinë e tyre në mënyrë grafike, si më poshtë:

